

Fjalimi i Guvernatorit, z. Bedri Hamza, në konferencën e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në temën “Ndikimi i Sektorit Bankar në Zhvillimin e Sektorit Privat”

Më lejoni që së pari të përgëzoj Odën Ekonomike Amerikane për organizimin e kësaj konference, që na mundëson t'i shohim së bashku ata që janë bartësit kryesorë të zhvillimit ekonomik të vendit dhe ata që bartin po ashtu një barrë shumë të rëndësishme, e që është financimi i zhvillimit ekonomik të vendit.

Zhvillimi ekonomik nuk mund të arrihet pa një sektor privat të zhvilluar. Zhvillimi i sektorit privat kërkon një sistem financiar në gjendje për të siguruar financim të qëndrueshëm dhe me kushte të favorshme për bizneset. Në anën tjetër, për të pasur një sektor financiar të zhvilluar, kërkohet që të kemi biznese të suksesshme, që me afarizmin e tyre arrijnë t'i kontribuojnë edhe vetë zhvillimit të sistemit financiar. Bazuar në këtë, konsiderojmë se bashkëveprimi efikas ndërmjet këtyre dy sektorëve paraqet një ndër parakushtet kryesore për zhvillimin ekonomik të vendit; mirëpo, ky bashkëveprim nuk mund të jetë efikas pa pasur një bashkëpunim të mirëfilltë ndërmjet të dy sektorëve për të tejkaluar së bashku sfidat që pengojnë avancimin e mëtejshëm të marrëdhënies ndërmjet sistemit financiar dhe bizneseve.

Prandaj, konferencat si kjo e sotmja kanë një rëndësi shumë të madhe me që mundësojnë një bashkëbisedim të hapur ndërmjet bankave dhe bizneseve, ku mund të diskutohen çështje të ndryshme të cilat janë të nevojshme për të avancuar edhe më tutje rolin e sektorit bankar në zhvillimin ekonomik të vendit.

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2015 po karakterizohet me ritëm të përshpejtuar të rritjes, të gjeneruar kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme. Norma vjetore e rritjes ekonomike në vitin 2015 pritet të arrijë në rreth 3.5 përqind. Rritja e kredive të reja konsumuese dhe remitencave kanë pasur ndikim të rëndësishëm në rritjen e të ardhurave të disponueshme të qytetarëve dhe rrjedhimisht, në rritjen e konsumit privat; përderisa edhe konsumi publik ka shënuar rritje. Kontribut të rëndësishëm në rritjen ekonomike gjatë këtij viti kanë dhënë edhe investimet, ku përveç investimeve vendore ka pasur edhe një rritje të konsiderueshme të investimeve të huaja direkte. Në anën tjetër, përkundër normës më të lartë të rritjes së eksportit,

niveli dukshëm më i lartë i importit të mallrave ka ndikuar që deficitin tregtar të mallrave të rritet për 2.7 përqind deri në tetor 2015. Eksporti i mallrave gjatë kësaj periudhe ka shënuar rritje vjetore prej 4.0 përqind, përderisa importi i mallrave është rritur për 2.9 përqind.

Dinamika e aktivitetit të sektorit bankar pa dyshim se ka qenë një ndër përcaktuesit kryesor të dinamikës së aktivitetit të përgjithshëm ekonomik në vend. Gjatë vitit 2015, aktiviteti kredihënës i sektorit bankar ka regjistruar shkallën më të lartë të rritjes në vitet e fundit. Në të njëjtën kohë, normat e interesit në kredi kanë shënuar rënie të theksuar, si dhe janë përmirësuar edhe kushtet tjera kreditore. Të gjitha këto flasin për një përmirësim të rëndësishëm të kushteve të financimit në ekonominë e vendit, të cilat janë reflektuar në shtimin e aktivitetit të përgjithshëm ekonomik.

Gjithsej vlera e kredive aktive në sektorin bankar të Kosovës në tetor 2015 arriti në 2 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 8.2 përqind, përderisa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kreditë kishin shënuar një normë vjetore të rritjes prej vetëm 3.1 përqind. Kategoria që i kontribuoi më shumti rritjes së gjithsej kredive ishte kategoria e kredive për ndërmarrjet, që shënoi një rritje vjetore prej 5.9 përqind. Vlen të theksohet, se në kuadër të kredive për ndërmarrjet, rritjen më të lartë e shënuan sektorët që kanë pjesëmarrje më të ulët në gjithsej kreditë e sektorit bankar, çka tregon se bankat kanë filluar të mendojnë më tepër për nevojën e diversifikimit të portofoleve të tyre dhe për përkrahje më të madhe për sektorët që kanë rëndësi të madhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Më konkretisht, sektorët që shënuan rritjen më të lartë të kredive të pranuar ishin sektori i prodhimit me rritje vjetore prej 16.7 përqind dhe sektori i bujqësisë me rritje prej 11.8 përqind në tetor 2015.

Përveç faktit se kemi përshpejtim të ritmit të kreditimit, është me rëndësi edhe fakti se pjesa më e madhe e kredive të reja të lëshuara në periudhën janar-tetor 2015 është lëshuar për qëllime investive të ndërmarrjeve. Në kuadër të gjithsej kredive të reja të lëshuara për ndërmarrjet gjatë kësaj periudhe, kreditë investive kishin një pjesëmarrje prej 64.3 përqind.

Prirja e sistemit bankar në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të vetë sistemit, si dhe në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit, vërehet edhe te struktura e kredive për ekonomitë familjare, ku është regjistruar një ritëm më i shpejtë i zhvillimit të tregut të kredive hipotekare. Në periudhën janar-tetor 2015, vlera e kredive të reja hipotekare ishte 55.8 milionë euro, e cila paraqet një rritje vjetore prej 36.6 përqind.

Përveç rritjes së vëllimit të kreditimit, viti 2015 është karakterizuar edhe me përmirësim substancial të kushteve të kreditimit. Norma mesatare e interesit në kredi në tetor 2015 ishte 8.2 përqind, krahasuar me normën prej 10.4 përqind në tetor 2014 dhe 11.4 përqind në tetor 2013. Ky nivel i normave të interesit tani më e ka bërë koston e financimit bankar në Kosovë të jetë në nivel të përafërt me koston e financimit në vendet tjera të rajonit, duke paraqitur kështu përmirësim të rëndësishëm në njërin prej fushave që në vazhdimësi është raportuar nga bizneset si pengesë për zhvillimin e afarizimit të tyre. Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, në veçanti vlenë të potencohet zvogëlimi i theksuar i normës së interesit për kreditë bujqësore, që në tetor 2015 kishin një mesatare prej 9.0 përqind, përderisa rreth dy vite më parë norma mesatare e interesit në këto kredi ishte rreth 20 përqind.

Duke ditur se normat e interesit në kredi në masë të madhe përcaktohen nga kostot që bartin bankat, pastaj nga rreziku me të cilin përballen bankat, si dhe nga kushtet e konkurrencës në treg, atëherë mund të vlerësojmë se zhvillimet në të gjitha këto aspekte gjatë periudhës së fundit kanë pasur rol të rëndësishëm në zvogëlimin e normës së interesit.

- Kostoja e ulët e financimit për bankat, e shprehur kryesisht nga normat e interesit në depozita, që në tetor 2015 kishin një mesatare prej 0.9 përqind, paraqet një ndër kontribuuesit kryesor në zvogëlimin e normës së interesit në kredi.
- Rreziku kreditor gjatë vitit 2015 ka shënuar rënie të mëtutjeshme. Norma edhe ashtu e ulët e kredive joperformuese, në tetor 2015 u zvogëlua edhe më tutje duke rënë në 6.8 përqind krahasuar me normën prej 8.7 përqind që ishte regjistruar në tetor 2015. Kjo normë e kredive joperformuese paraqet nivelin më të ulët të regjistruar që nga qershori i

vitit 2012 dhe vazhdon ta mbajë Kosovën si vendin me normën më të ulët të kredive joperformuese në rajon.

- Për sa i përket zhvillimeve në fushën e konkurrencës, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në vazhdimësi ka punuar për të siguruar kushtet e zhvillimit të konkurrencës në sistemin financiar të Kosovës. Në këtë kontekst, shtimi i vazhdueshëm i bankave të licencuara për të operuar në Kosovë ka rezultuar në rritje të konkurrencës në tregun bankar, e cila ka nxitur zhvillimin e produkteve të reja dhe rritjen e efikasitetit në këtë sektor. Si tregues për shtimin e konkurrencës në sektorin bankar mund të shërbejë edhe treguesi i shkallës së koncentrimit të tregut bankar i cili, me gjithë se ende mbetet në nivel të lartë, po shënon rënie të vazhdueshme.

Bazuar në atë që prezantova deri më tani, vlerësoj se roli i sektorit bankar të Kosovës në zhvillimin ekonomik të vendit është i madh dhe në rritje. Sidoqoftë, me gjithë rritjen e vazhdueshme të kreditimit, raporti ndërmjet gjithsej kredive dhe Bruto Produktit Vendor mbetet në rreth 35 përqind, raport ky më i ulët krahasuar me vendet tjera të rajonit dhe ekonomitë më të zhvilluara. Kjo tregon se ekonomia e vendit, marrë për bazë madhësinë e saj, ka kapacitete për të absorbuar zgjerimin e mëtutjeshëm të kreditimit bankar.

Se si mund të arrijmë deri te një shkallë më e lartë e kreditimit sigurisht se do të mund të dëgjojmë më tepër nga përfaqësuesit e bankave komerciale të ftuar në këtë konferencë dhe po ashtu nga përfaqësuesit e bizneseve këtu në audiencë. Megjithatë, unë dëshiroj të potencoj se nevojën për rritje të shkallës së ndërmjetësimit financiar nuk duhet parë vetëm nga ana e ofertës për kredi, por njësoj e rëndësishme është edhe ana e kërkesës për kredi, me ç'rast kërkohet nga bizneset të aplikojnë për kredi me projekte cilësore dhe të rrisin transparencën përmes raportimit financiar objektiv. Për më tepër, rritjen e kreditimit nuk duhet ta shikojmë vetëm në kuptimin e kreditimit të huamarrësve ekzistues, te të cilët vëmendje të veçantë duhet t'i kushtojmë edhe rrezikut të mundshëm nga mbingarkesa me borxh. Në këtë kontekst, nevojitet që zgjerimi i ndërmjetësimit financiar të bëhet edhe përmes zgjerimit të bazës së klientelës bankare, duke siguruar një shkallë më të lartë të përfshirjes së qytetarëve dhe bizneseve me qasje në shërbimet bankare.

Në këtë drejtim, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës e vlerëson si shumë të rëndësishëm edhe edukimin financiar të publikut, fushë kjo në të cilën po angazhohemi në mënyrë intensive përmes aktiviteteve të ndryshme.

Për fund, dëshiroj të shpreh gatishmërinë dhe përkushtimin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për të siguruar një sistem financiar të qëndrueshëm dhe për të ndihmuar zhvillimin e mëtejshëm të këtij sistemi në mënyrë që ekonomia e vendit të gëzojë shërbime financiare efikase dhe të sigurta.

Ju dëshiroj një ditë të mbarë me besimin se diskutimet që do të bëhen në këtë konferencë do t'i kontribuojnë avancimit të mëtejshëm të rolit të sektorit bankar në zhvillimin e ekonomisë së vendit.